

Z. Ardian Myslimaj ka përfunduar studimet në Akademinë Ushtarake në vitin 1991. Ka kryer studimet për Juridik në Univeritetin e Tiranës. Ka përfunduar studimet Master për Studime Europiane. Ka kryer studimet në Kolegjin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si dhe Kursin e Lartë Ekzekutiv në Qendrën “G.Marshall”.

Aktualisht ka titullin “Prof. Asoc. Dr.”

Ka punuar pedagog në Akademinë Ushtarake në vitin 1991-1992.

Nga viti 1993-1997, ka punuar si gazetar.

Z. Myslimaj ka qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë nga viti 1997-2005. Më pas, 2007-2014 ka punuar në Universitetin Ushtarak dhe Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”. 2016-2021 ka punuar si administrator i Qendrës për Regjistrimin e Aksioneve në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Marrëdhëniet e punës në Kontrollin e Lartë të Shtetit i ka filluar nga marsi 2021 si këshilltar në Kabinetin e Kryetarit të KLSH-së.

Aktualisht është në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në Kontrollin e Lartë të Shtetit.